



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 745/24
Dt. 16.09.2024

Në bazë të nenit 130 pika 1 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 lidhur me nenin 108/A paragrafi 2 të Ligjit për prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, për shkak se Autoriteti Kontraktues ka pranuar Kërkesë për Rishqyrtim të Njoftimit për Kontratë, në aktivitetin e prokurimit: *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit, ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim*, Numri i prokurimit: VU644-24-8479-5-1-1, me dt 16.09.2024, nxjerrë:

KONKLUZION

Për Pezullimin e përkohshëm të Aktivitetit të Prokurimit

I. PEZULLOHET përkohësisht zbatimi i aktivitetit të prokurimit lidhur me projektin: *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit, ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim* Numri i prokurimit: VU644-24-8479-5-1-1, për shkak se është dorëzuar Ankesë në OSHP.

II. Ky Konkluzion hynë fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes, ndërsa do të zgjasë deri në marrjen e një vendim të plotëfuqishëm nga OSHP, lidhur me këtë çështje.

III. Konkluzioni publikohet në platformën elektronike në adresën: [Http://e-prokurimi.rks-gove.net/](http://e-prokurimi.rks-gove.net/)

Arsyetim

Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Blerësit, për nevoja të saja ka iniciuar dhe zbatuar aktivitetin e prokurimit: : *Ndertimi i stacionit te pompimit rrjetit primar dhe rezervuarve te ujit, ne pjesen lindore te Vushtrri sipas lot I dhe lot II-ri tenderim* Numri i prokurimit: VU644-24-8479-5-1-1, Bazuar në Ankesën e datës 16.09.2024 të Op. Ek. për rishqyrtim të Njoftimit për Kontratë të dt. 23.08.2024, mbështetur në dispozitat e nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, citat: “ *Dorëzimi i një Kërkesë për shqyrtim* obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloi zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar” mbarim citati, në funksionin e Menaxherit të Prokurimit pran Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, kamë nxjerrë Konkluzionin me efektet si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesë e veçantë.



Ilmi Azemi

ZPP